



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

**Zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale
dhe procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare,
sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit**

17 Nëntor 2018

Seksioni I

**Pyetje me alternativa (1 pikë secila).
Zgjidhni alternativën e saktë.**

- 1. Sipas Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organiziminin e profesionit të audituesit ligjor” “Rrjet i audituesve ligjorë” është një strukturë e madhe bashkëpunimi, ku marrin pjesë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, e cila ka për qëllim:**
 - a) Realizimin e ndarjes së fitimit apo kostos, pronësinë, drejtimin ose kontrollin e përbashkët;
 - b) Krijimin e politikave dhe procedurave të njëjta të kontrollit të cilësisë, strategji biznesi të përbashkët;
 - c) Të dyja së bashku;
 - d) Asnjëra.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

- 2. Qëllimi i rishikimit të pasqyrave financiare është t’i japë mundësi një profesionisti të praktikës/auditues ligjorë:**
 - a) Për të konkluduar mbi paraqitjen e drejtë dhe të sinqertë të pasqyrave financiare;
 - b) Për të shprehur një opinion nëse pasqyrat nuk japin pamjen e drejtë dhe të sinqertë;
 - c) Për të shprehur opinion se pasqyrat financiare japin pamjen e drejtë dhe të sinqertë;
 - d) Për të shprehur një siguri në formë negative.

Përgjigja e saktë është alternativa (D)

- 3. Cili nga përshkrimet e mëposhtme është shpjegimi më i saktë për termin “gjyrimi profesional”:**
 - a) Aplikimi i trajnimit, njohurive dhe eksperiencës përkatëse brenda kontekstit të dhënë nga standardet e auditimit, kontabilitetit dhe etikës, në marrjen e vendimeve të informuara, të përshtatshme për rrethanat e angazhimit;

- b) Aplikimi i procedurave, standardeve dhe i normave etike dhe morale që përcaktohen nga natyra e biznesit të angazhimit;
- c) Aplikimi i standardeve të auditimit, kontabilitetit, dhe etikës në marrjen e vendimeve të informuara që janë në favor të angazhimit dhe që përputhen me dëshirat e shoqërisë që auditohet;
- d) Asnjëra nga alternativat.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

4. Cila nga përshkrimet e mëposhtme përfaqëson më saktë se çfarë është një rishikim i kontrollit të cilësisë së angazhimit:
- a) Një vlerësim i efektivitetit të operimit të elementëve të kontrollit të klientit;
 - b) Një vlerësim objektiv i gjykimeve të rëndësishme të kryera nga grupi i angazhimit;**
 - c) Një vlerësim për të siguruar që shoqëria nuk është në rrezik likuidimi;
 - d) Një vlerësim i performancës së grupit të angazhimit.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

5. SNA 500 kërkon që evidenca e auditimit të jetë:
- a) E mjaftueshme dhe e përshtatshme;**
 - b) E përshtatshme dhe efikase;
 - c) E mjaftueshme dhe e besueshme;
 - d) E besueshme dhe materiale .

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

6. Në cilin nga rastet më poshtë nënshkrimi i një letre përfaqësimi nga drejtuesit e entitetit është i mjaftueshëm si evidencë auditimi?
- a) Kur çështja vendoset dhe përcaktohet tërësisht vetëm nga qëllimet dhe synimet e drejtuesve;**
 - b) Kur dihet me siguri që drejtuesit janë të ndershëm;
 - c) Kur shoqëria nuk është e listuar në bursë;
 - d) Kur audituesit nuk kanë kohë të kryejnë procedura të tjera.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

7. Cili prej pohimeve të mëposhme në lidhje me materialitetin është i saktë:
- a) Materialiteti bazohet në gjykimin e audituesit;**
 - b) Materialiteti duhet të llogaritet vetëm në fazën e planifikimit të auditimit;
 - c) Materialiteti llogaritet gjithmonë bazuar në të ardhurat;
 - d) Materialiteti llogaritet gjithmonë bazuar në totalin e aktiveve.

Përgjigja e saktë është alternativa (A)

8. Cila prej alternativave më poshtë është e saktë:

- a) Procedurat analitike mund të përdoren gjatë gjithë procesit të auditimit ;
- b) Procedurat analitike duhet të përdoren si procedura për vlerësimin e rreziqeve;
- c) a dhe b;
- d) Asnjë nga alternativat e mësipërme.

Përgjigja e saktë është alternativa (C)

9. Gjatë kryerjes së një auditimi, një auditues duhet të mbajë në konsideratë:

- a) Të gjitha SNA-te;
- b) Të gjitha SNA-të që kanë lidhje me/ose janë të zbatueshme për auditimin;
- c) Të gjitha SNA-të që hyjnë në fuqi në vitin për të cilin po kryhet auditimi;
- d) Ato SNA që kërkohen për zbatim sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

10. Gjetjet e auditimit duhet ti komunikohen:

- a) Drejtimit të Shoqërisë ose personit që ka nënshkruar letrën e angazhimit;
- b) Drejtimit të Shoqërisë dhe personave të ngarkuar me qeverisjen;
- c) Drejtuesit Ekzekutiv dhe Drejtuesit Financiar;
- d) (a) dhe (c).

Përgjigja e saktë është alternativa (B)

Seksioni II

Organizimi i profesionit të audituesit ligjor

11. Tregoni rastet kur një auditues ligjor ose shoqëria audituese, gjatë ushtrimit të auditimit, ka përgjegjësinë dhe detyrimin e zhdëmtimit të pasojave financiare.

4 pikë

Përgjigje:

Audituesi ligjor ose shoqëria audituese, gjatë ushtrimit të auditimit, ka përgjegjësinë dhe detyrimin e zhdëmtimit të pasojave financiare, që vijnë drejtpërdrejt nga gabimi apo faji i tij në punë. Pa iu shmangur kësaj përgjegjësie, audituesi ligjor apo shoqëria audituese, nga njëra anë dhe klienti i tyre, nga ana tjetër, mund të bien dakord për kufizimin e kësaj përgjegjësie, deri në një shumë të paracaktuar, në letrën e tyre të angazhimit.

12. Tregoni shkurtimisht cilat janë llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të parashikuara në ligjin 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesve ligjorë.." i ndryshuar. Në cilat raste jepen ato (thjesht evidentoni disa prej tyre) dhe kush e ka kompetencën e marrjes së tyre.

5 pikë

Përgjigje:

1- Masat disiplinore për audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit janë:

- a) vërejtje me shënim në regjistrin publik;
- b) gjobë;
- c) pezullim i përkohshëm, për një kohë jo më shumë se pesë vjet;
- ç) fshirje e përhershme nga regjistri publik, e cila përmban ndalimin, përgjithmonë, të ushtrimit të profesionit.

2- Kompetenca e marrjes së masave disiplinore i takon Bordit të Mbikëqyrjes Publike

3- Disa raste të masave disiplinore

Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1.

Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1 Dënimi me gjobë, jepet në disa raste midis të cilave mund të përmendimin:

- kur audituesi ligjor ka bërë kërkesë për çregjistrim, me arsyen e fillimit të një veprimtarie të re, dhe e ka nisur veprimtarinë e re, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, përpara marrjes së vendimit nga komiteti i regjistrimit, sipas afateve të parashikuara në rregulloren e miratuar;
- në raste se në përfundim të procesit të kontrollit të cilësisë, rezulton që puna audituese nuk është kryer në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me kërkesat e këtij ligji e akteve nënligjore;
- në rastin e mosdhënies së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, në kuadër të procesit të kontrollit të cilësisë;

- në rast të mosndjekjes së rregullave dhe procedurave të auditimit, që kanë sjellë dhënien e një opinioni të mangët ose të gabuar për pasqyrat financiare subjekt auditimi;
- në rast se nuk respektohen kërkesat e parashikuara nga neni 34, i këtij ligji, për mbrojtjen e konfidencialitetit;
- në rastin kur informacionet vjetore statutores, të paraqitura pranë organizatës profesionale të audituesve ligjorë, janë të pasakta.

Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, jepet në rastet kur:

- audituesi ligjor, gjatë funksioneve të tij, kryen edhe funksionin e të punësuarit apo funksione të tjera, që janë në papajtueshmëri me profesionin e audituesit ligjor;
- marrja përsipër e misionit të auditimit është bërë pa respektuar procedurat e emërimit të tij, të parashikuara nga dispozitat e këtij ligji, si dhe nga rregullat e auditimit apo nga statuti;
- vërtetohet se raporti i auditimit nuk bazohet në dokumentacionin që përmban dosja e auditimit;
- nga rezultatet e kontrollit të cilësisë rezulton vlerësimi “dobët”;

Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, jepet në rastet kur:

- shërbimet e auditimit të pasqyrave financiare bazohen, në një masë të madhe, te rezultatet e rishikimeve periodike të pasqyrave financiare të përmbledhura dhe të auditimit të brendshëm, që janë kryer nga vetë audituesi ligjor apo shoqëria audituese;
- audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit përfshihen në shërbime të dhënies së sigurisë për pasqyrat financiare, që përgatiten për qëllime të klientit, kur verifikohet se këto të fundit janë informale dhe të ndryshme nga pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme;
- shkelja e përcaktuar në pikën 6 dhe shkeljet e përcaktuara në pikën 9, të këtij neni, përsëriten më shumë se dy herë.

Seksioni III

Etika Profesionale

- 13.** Përmendni 4 masa mbrojtëse të përgjithshme që mund të vendosen në mjedisin e punës, të cilat i shërbejnë firmës së auditimit për të shmangur apo zvogëluar kërcënimet që i kanosen parimeve themelore të Kodit të Etikës.

4 pikë

Përgjigje:

Kandidati duhet të ketë përmendur të paktën 4 nga masat e mëposhtme apo të tjera të ngjashme në natyrë me sa më poshtë:

- Lidërshipi i firmës thekson rëndësinë e respektimit të parimeve themelore dhe përforcon besimin se anëtarët e grupit të dhënies së sigurisë do të veprojnë në interes të publikut.
- Vënia në funksionim e politikave dhe procedurave që shërbejnë për të zbatuar e monitoruar kontrollin e cilësisë së angazhimeve.
- Vendosja e politikave të dokumentuara që shërbejnë: për të identifikuar kërcënimet që i bëhen respektimit të parimeve themelore, për vlerësimin e rëndësisë së kërcënimeve dhe për identifikimin e zbatimit të atyre masave mbrojtëse, të cilat eliminimojnë apo zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm, përveç rasteve kur kërcënimet janë krejt të parëndësishme.

- Në rastin e firmave që kryejnë angazhime të dhënies së sigurisë, vendosja në funksionim e atyre e politikave që dokumentojnë pavarësinë, të cilat shërbejnë për identifikimin e kërcënimeve që i bëhen pavarësisë, vlerësimin e rëndësisë së këtyre kërcënimeve, si edhe vlerësimin e zbatimit e masave mbrojtëse që i eliminojnë apo zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm, përveç atyre kërcënimeve që janë krejt të parëndësishme.
- Vendosja e politikave dhe procedurave të brendëshme të dokumentuara, që kërkojnë respektimin e parimeve themelore.
- Vendosja e politikave dhe procedurave që bëjnë të mundur identifikimin e interesave ose marrëdhënieve që ekzistojnë midis firmës apo anëtarëve të grupeve të angazhimit dhe klientëve.
- Përdorimi i partnerëve të ndryshëm dhe i grupeve të ndryshme të angazhimit me linja të veçanta raportimi, për dhënien e shërbimeve të josigurisë për një klient që eksperti kontabël i regjistruar i jep shërbimin e sigurisë.
- Vendosja e politikave dhe procedurave, të cilat ndalojnë individët, që s'janë anëtarë të një grupi të angazhimit, të influencojnë në mënyrë të papërshtatëshme rezultatin e angazhimit.
- Komunikimi në kohë i politikave dhe procedurave të një firme, përfshirë ndryshimet që bëhen, për të gjithë partneret e stafin tjetër profesional dhe trainimi e formimi i duhur për zbatimin e këtyre politikave e procedurave.
- Caktimi i një anëtarë të nivelit të lartë të drejtimit me përgjegjësinë për të mbikëqyrur funksionimin e duhur të sistemit të kontrollit të cilësisë të firmës.
- Informimi i partnerëve dhe i stafit profesional për ato klientë që ju jepet siguria dhe për entitetet përkatëse, nga të cilët ata duhet të jenë të pavarur.
- Vendosja e një mekanizmi disiplinor që nxit respektimin e politikave dhe procedurave.
- Vendosja e politikave dhe procedurave të publikuara, që shërbejnë për të inkurajuar dhe për t'i dhënë pushtet personelit të firmës së auditimit, me qëllim që ai të komunikojë me nivelet e larta brenda firmës, për çdo çështje shqetësuese që ka lidhje me respektimin e parimeve themelore.

14. Klienti Megatron shpk është një klient i vjetër i firmës suaj dhe një shoqëri e listuar në bursë. Endri Ledhi ka qënë partneri i auditit për 7 vite dhe kupton se një partner i ri auditimi duhet të zërë vendin e tij. Endri po shpreson që të mbetet në kontakt me klientin dhe që të veprojë si një rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit në auditimet e pasardhëse.

Shpjegoni rreziqet etike që lindin nga lidhja e gjatë e një partneri/ortaku në pozicion kyc me një klient auditimi, cilat masa mbrojtëse mund të vendosen, si dhe shpjegoni nëse Endri mund të veprojë si një rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit.

5 pikë

Përgjigje:

Krijimi i një raporti profesional dhe bashkëpunimi për një kohë të gjatë e partnerit, Endrit me klientin rrezikon të ulë nivelin e skepticizmit profesional që ai i sjell procesit të auditimit për shoqërinë Megatron shpk. Pas kalimit të një kohe të gjatë ai mund të bëhet shumë pranues i mendësisë së klientit në raportimin financiar, dhe mund të fillojë të mos kuptojë problematikat që mund ti shihte dikush me sy të freskët. Pra, në këtë mënyrë partnerit mund ti ulet aftësia për të rishikuar dhe vlerësuar në mënyrë objektive shoqërinë.

Rreziku i familiaritetit mund të krijohet për shkak të raportit të ngushtë që mund të jetë krijuar midis Endrit dhe klientit. Ky rrezik duhet të vlerësohet në bazë të faktorëve të mëposhtëm:

- Pozicioni i audituesit (Endri është partner, kështu që në pozicion shumë të lartë në hierarkinë e firmës së auditimit);
- Kohëzgjatja (7 vite janë një kohë e gjatë);
- Natyra, frekuenca dhe sa shpesh ka pasur marrëdhënie me menaxhimin e shoqërisë që është nën auditim (kjo nuk përmendet në skenarin tonë, pra nuk mund të supozojmë);

Masat mbrojtëse që mund të merren për të mënjeluar këtë rrezik përfshijnë:

- Rotacion të personelit kyc të përfshirë në angazhim;
- Rishikim të punës së personelit kyc nga një auditues ligjor që nuk është i përfshirë në angazhimin e auditimit;
- Rishikime të rregullta të kontrollit të cilësisë së angazhimit;

Rreziku i një entiteti të listuar – mund të krijohet duke pasur parasysh se Megatron është një entitet i listuar në bursë. Sipas kodit të etikës së IESBA, një partner kyc si Endri duhet të ndryshohet pas 7 vitesh. Sipas kodit, një partner që ka qënë i përfshirë në një angazhim auditimi në një rol kyc për një periudhë prej 7 vitesh, duhet të largohet nga angazhimi për një periudhë “ftohjeje” prej 2 vitesh, dhe pas kësaj periudhe mund të përfshihet sërish në angazhim. Megjithatë, Kodi i Etikës lejon që partneri kyc të përfshihet edhe për një vit tjetër pas 7 viteve, nëse për shkak të situatave të paparashikuara që janë përtej kontrollit të firmës së auditimit, vazhdimësia e partnerit në angazhim është e rëndësishme për cilësinë e auditimit. Megjithatë në situatën e përshkruar në rastin e Megatron nuk duken të plotësohet kushti për zgjatjen e 7 viteve me një vit shtesë.

Duke marrë parasysh kërkesat e Kodit të Etikës për periudhën e “ftohjes” nuk duhet që Endri të përfshihet si rishikues i kontrollit të cilësisë së angazhimit, të paktën për 2 vite.

Seksioni IV

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

15. Shoqëria AB ofron suport në mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit dhe shërbime të tjera të ngjashme për firmat e ndërtimit. Shoqëria është themeluar nga 3 ortakë, të cilët janë gjithashtu, edhe të angazhuar me administrimin e shoqërisë. Ju jeni audituesi për pasqyrat financiare që mbyllen më 31 Dhjetor 2018. Pas një vizite te klienti AB, ju keni marrë informacionin e mëposhtëm:

- a- Shoqëria ka lidhur kontrata 10 vjeçare me klientët e saj dhe i faturon klientëve një tarifë vjetore për mirëmbajtjen rutinë që ofron. Tarifa për vitin e parë paguhet me lidhjen e kontratës dhe tarifat për vitet në vijim paguhet në avancë.
- b- Për çdo shërbim shtesë, përveç mirëmbajtjes rutinë, klientët faturohen sipas shërbimeve të ofruara. Personi përgjegjës, për lëshimin e faturës së shitjes, e plotëson faturën duke u bazuar në çmimet e faturave të mëparshme.

- c- Shoqëria AB ka si klientë vetëm 5 firma ndërtimi. Çmimet që i janë ofruar klientëve janë pothuajse të ngjashme dhe kanë qënë me përfitime për shoqërinë AB.
- d- Kontrata me një prej firmave të ndërtimit përfundon në Janar të vitit 2019. Rinovimi i kontratës për këtë klient do të tenderohet.
- e- Shoqëria AB ka 20 vite që operon në treg.

Bazuar në informacionin e dhënë më sipër, përshkruani 4 rreziqe të auditimit dhe mënyrën e përgjigjes/reagimit së Audituesit ndaj secilit rrezik, gjatë planifikimit të auditimit të Shoqërisë AB.

4 pikë

Përgjigje:

Rreziku:

- a- Duke qënë se shoqëria faturon në avancë mirëmbajtjen rutinë, ekziston rreziku që të ardhurat të jenë të mbivlerësuara, duke mos u njohur të ardhura të shtyra.

Përgjigjia:

- a- Të verifikohen kontratat dhe të rikalkulohen të ardhurat sipas termave të kontratës. Më pas rikalkulimet të krahasohen me të ardhurat e njohura në pasqyrat financiare.

Rreziku:

- b- Duke qënë se cmimet vendosen sipas faturave të mëparshme, ekziston rreziku që nëse cmimi është vendosur gabim në faturën e mëparshme, të vazhdojë të vendoset me gabim në faturat e mëpasshme.

Përgjigjia:

- b- Të verifikohen disa fatura dhe të kontrollohen nëse cmimet e vendosura janë njësoj me cmimet e kontratës.

Rreziku:

- c- Duke qënë se shoqëria ka një numër të kufizuar klientësh, ekziston rreziku që humbja e një prej klientëve të cojë në pikëpyetje vazhdimin e shoqërisë në vijimësi.

Përgjigjia:

- c- Të verifikohen kontratat e klientëve për të vlerësuar rrezikun e humbjes së klientit.

Rreziku:

- d- Duke qënë se kontrata me një prej klientët mbaron në Janar të vitit 2019, ekziston rreziku që shoqëria të mos ketë vijimësi dhe nëse kjo qëndron pasqyrat financiare nuk duhen përgatitur sipas parimit të vijimësisë.

Përgjigjia:

- d- Të diskutohet me drejtuesit e shoqërisë nëse kanë marrë masa për të lidhur kontrata të tjera për të siguruar vijimësinë e biznesit.

16. Ju jeni audituesi për pasqyrat financiare të shoqërisë AB që mbyllen më 31 Dhjetor 2018. Pas një vizite te klienti AB, ju keni marrë informacionin më poshtë:

- a) Auditimi i pasqyrave financiare të vitit që mbyllet më 31 Dhjetor 2017 është kryer nga një firmë tjetër auditimi;
- b) Shoqëria AB ka ndërruar programin e saj financiar më 31 Korrik 2018

c) Shoqëria AB ka patur probleme me produktet e blera nga klientët e saj, për të cilat ka patur pretendime ligjore dhe ka rezultuar që klientët të mos paguajnë për produktet e blera.

d) Shitjet janë rritur gjatë fundit të vitit duke ofruar terma të reja të pagesës më të favorshme për klientët. Termat e mëparshme ishin pagesë një muaj nga data e faturës, termat e reja të pagesës janë bërë 3 muaj pas datës së faturës. Si pasojë e këtij ndryshimi, llogaritë e arkëtueshme janë rritur nga 2 milion në 5 milion.

a) Shpjegoni pse është i rëndësishëm për audituesit planifikimi i auditimit.

b) Përshkruani tre çështje që duhet të konsiderohen gjatë planifikimit të auditimit dhe veprimet që duhet të ndërmerrni si auditues në lidhje me informacionin e marrë më sipër.

4 pike

Përgjigje:

a) Shpjegoni pse është i rëndësishëm për audituesit planifikimi i auditimit.

Planifikimi i auditimit është i rëndësishëm pasi lejon audituesin për të caktuar stafin e duhur, kohën e duhur gjatë auditimit, fokusimin në çështjet e vlerësuara me rrezik të lartë, kryerjen në kohë të auditimit dhe do të mundësojë që rishikimi cilësor i auditimit të kryhet më lehtë.

b) Përshkruani tre çështje që duhet të konsiderohen gjatë planifikimit të auditimit dhe veprimet që duhet të ndërmerrni si auditues në lidhje me informacionin e marrë më sipër.

Çështja:

1- Shoqëria ka ndërruar programin e saj financiar gjatë vitit financiar që do të auditohet. Si pasojë ekziston rreziku që transferimi i tepricave të llogarive të kenë gabime të mundshme gjatë transfrimit të tyre tek program i ri financiar.

Veprimi:

1- Të verifikohet procesi i transferimit të tepricave të llogarive dhe testimet e kryera nga shoqëria për verifikimin e tepricave të transferuara. Gjithashtu mund të kryhen testime për verifikimin e këtyre tepricave.

Çështja:

2- Duke qënë se klientët kanë patur pretendime ligjore ndaj entitetit, duhet të merret në konsideratë provizionimi i këtyre pretendimeve.

Veprimi:

2- Të verifikohet natyra e pretendimeve të klientëve të entitetit si dhe të diskutohet me avokatët e entitetit për të marrë një vlerësim në lidhje me vendimet e pretendimeve ligjore.

Çështja:

3- Rritja e ndjeshme e llogarive të arkëtueshme mund të sjellë probleme me flukset monetare të disponueshme nga entitetit, gjë që mund të cojë në vështirësi për të vazhduar biznesin në vijimësi.

Veprimi:

- 3- Të verifikohet pozicioni i flukseve monetare në fund të vitit dhe planifikimi i tyre për vitin në vazhdim, në mënyrë që të vlerësohet nëse shoqëria do të hasë probleme me flukset monetare.

17. Më poshtë jepen të dhëna në Lekë në lidhje me entitetin AB. Industria në të cilën operon shoqëria ka një rritje prej 5%.

Zërat	2016	2017
Të ardhura	5,000,000	6,000,000
Kosto e shitjes	3,100,000	4,800,000
Marzhi bruto	1,900,000	1,200,000
Shpenzime administrative	500,000	550,000
Marzhi neto	1,400,000	650,000
Aktivitet Afatgjata	4,500,000	3,600,000
Inventari	1,300,000	200,000
Llogaritë e arkëtueshme	4,000,000	6,000,000
Mjete monetare dhe Banka	1,600,000	500,000
Kapitali dhe rezervat	1,000,000	1,000,000
Fitimi i pashpërndarë	5,750,000	5,300,000
Detyrimet afatgjata	2,050,000	1,000,000
Detyrimet afatshkurtra	2,600,000	3,000,000

- a) Llogarisni materialitetin, duke marrë parasysh referencat e sugjeruara nga SNA-të.

- b) Identifikoni dhe shpjegoni minimumi 5 zëra me rrezik të lartë.

5 pikë

Përgjigje:

- a) Llogarisni materialitetin, duke marrë parasysh referencat e sugjeruara nga SNA-të.

Materialiteti 2016:

½-1% e të ardhurave: $(1/2\% * 5,000,000 - 1\% * 5,000,000)$ 25,000- 50,000

5-10% e fitimit para tatimit: $(5\% * 1,400,000 - 10\% * 1,400,000)$ 70,000- 140,000

1-2% e totalit të aktiveve: $(1\% * 11,400,000 - 2\% * 11,400,000)$ 114,000- 228,000

Materialiteti 2017:

½-1% e të ardhurave: $(1/2\% * 6,000,000 - 1\% * 6,000,000)$ 30,000- 60,000

5-10% e fitimit para tatimit: $(5\% * 650,000 - 10\% * 650,000)$ 32,500- 65,000

1-2% e totalit të aktiveve: $(1\% * 10,300,000 - 2\% * 10,300,000)$ 103,000- 206,000

- b) Identifikoni dhe shpjegoni minimumi 5 zëra me rrezik të lartë.

1- Të ardhura nga shitjet

Të ardhurat nga shitjet kanë një rritje prej 20%. Industria ka një rritje 5%. Ka rrezik që shitjet të jenë mbivlerësuar.

2- Kosto e shitjes

Kosto e shitjes është rritur nga 62% në 80%. Edhe pser treguesit aktual nuk tregojnë rrezikshmëri në lidhje me vijimin e biznesit, nëse rritja e kostos së shitjes vazhdon më te,

biznesi në vijimësi mund të cenohet. Gjithashtu, mund të jetë tregues për alokim të pasaktë të kostos së shitjes. Regjistrimet kontabël duhet të verifikohen.

3- Marzhi

Marzhir bruto ka rënë nga 38% në 20%, marzhi neto ka rënë nga 28% në 10,83%. Kjo rënie mund të tregojë që entiteti të ketë ulur cmimet në mënyrë të ndjeshme. Edhe pse treguesit aktual nuk tregojnë rrezikshmëri në lidhje me vijueshmërinë e biznesit, nëse rënia vazhdon më tej biznesi në vijimësi mund të cenohet.

4- Aktivët afatgjatë materiale

Ka një rënie me 900,000 Lekë (20%). Duhet të verifikohen normat e zhvlerësimit për të parë nëse rënia është përtej normave të zhvlerësimit. Nëse vlera e zhvlerësimit është më e ulët, duhen rishikuar regjistrimet kontabël.

5- Inventari

Inventari ka rënë ndjeshëm. Duhet të rishikohen regjistrimet kontabël në lidhje me të, për sa i përket sasisë në fund të vitit dhe vlerësimit të inventarit.

(Cështje të tjera: llogaritë e arkëtueshme, detyrimet afatgjatë, mjetet monetare)

18. a) Shpjegoni ç'kuptoni me "Plan Auditimi" dhe rastet kur ky plan ndryshohet.

b) Shpjegoni se cfarë konsiderata shtesë duhet të merren parasysh për angazhime të auditimit përherë të parë.

4 pikë

Përgjigje:

a) Shpjegoni ç'kuptoni me "Plan Auditimi" dhe rastet kur ky plan ndryshohet.

Plani i auditimit është më i detajuar se strategjia e përgjithshme e auditimit në kuptimin që përfshin natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit që duhet të kryhen nga anëtarët e ekipit të angazhimit. Planifikimi për këto procedura të auditimit zhvillohet gjatë rrjedhës së auditimit, pasi plani i auditimit për angazhimin zhvillohet. Për shembull, planifikimi i procedurave të vlerësimit të rrezikut ndodh herët në procesin e auditimit. Megjithatë, planifikimi i natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave specifike të mëtejshme të auditimit varen nga rezultati i këtyre procedurave të vlerësimeve të rrezikut. Përveç kësaj, audituesi mund të fillojë kryerjen e procedurave të mëtejshme të auditimit për disa kategori të transaksioneve, tepricat e llogarive dhe dhënien e informacioneve shpjeguese para planifikimit të të gjitha procedurave të mbetura për tu kryer auditimi.

Si rezultat i ngjarjeve të papritura, ndryshimeve në kushte ose evidencave të auditimit marrë nga rezultatet e procedurave të auditimit, audituesi mund të ketë nevojë të modifikojë strategjinë e përgjithshme të auditimit dhe planin e auditimit dhe rrjedhimisht natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të planifikuara të mëtejshme të auditimit, bazuar në gjykimin e rishikuar për rreziqet e vlerësuara. Ky mund të jetë rasti kur informacioni që vjen në vëmendjen e audituesit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga informacioni në dispozicion kur audituesi ka planifikuar procedurat e auditimit.

b) Shpjegoni se cfarë konsiderata shtesë duhet të merren parasysh për angazhime të auditimit përherë të parë.

Për një angazhim fillestar të auditimit, çështjet shtesë që audituesi mund të marrë në konsideratë në krijimin e strategjisë së përgjithshme të auditimit dhe planit të auditimit janë si në vijim:

- 1- Me përjashtim të rasteve kur ndalohet me ligj ose rregullore, duhet të komunikohet me audituesin e mëparshëm, për shembull, për të shqyrtuar dokumentet e punës së audituesit paraardhës.
- 2- Çdo çështje me rëndësi (përfshirë zbatimin e parimeve të kontabilitetit ose e standardeve të auditimit dhe raportimit) të diskutuara me drejtimin në lidhje me zgjedhjen për herë të parë si auditues, komunikimin mbi këto çështje me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe si këto çështje ndikojnë në strategjinë e përgjithshme të auditimit dhe planin e auditimit.
- 3- Procedurat e auditimit të nevojshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshëm dhe të përshtatshme lidhur me tepricat e celjes.
- 4- Procedurat e tjera të kërkuara nga sistemi i kontrollit të cilësisë së firmës së auditimit, për angazhimet fillestare të auditimit.

19. Çfarë kuptoni me refuzim të dhenies së opinionit të auditesit? Nga ndryshon refuzimi nga dhënia e një opinionit kundër?

Partneri juaj i firmës së auditimit shprehet si më poshtë:

“Jam duke përgatitur raportin e audituesit për klientin Shoqërinë Albania Co. Nesër unë nisem me pushime dhe dua që raporti i audituesit të firmoset dhe ti vendoset data para se unë të nisem. E vetmja gjë që më mbetet është letra e përfaqësimit me shkrim nga drejtuesit e shoqërisë – e kam konfirmuar gjatë një bisede se çfarë do të përmbajë përfaqësimi i shkruar me drejtorin e departamentit të financës, dhe do ma dërgojë brenda javës që vjen. Besoj kjo është e pranueshme?”

Komentoni pranueshmërinë e komenteve të partnerit tuaj duke ju referuar dispozitave të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit përkatës.

4 pikë

Përgjigje:

Refuzim i dhënies së opinionit nga dhënia e një opinionit kundër:

Audituesi duhet të refuzojë dhënien e një opinionit kur ai nuk është në gjendje të marrë evidencën e nevojshme të auditimit mbi të cilën të mbështesë opinionin dhe audituesi arrin në përfundimin se ndikimet e mundshme në pasqyrat financiare të anomalive të pazbuluara, nëse do të kishte të tilla, mund të jenë materiale dhe të përhapura. Audituesi duhet të refuzojë të japë një opinion kur, në rrethana jashtëzakonisht të rralla që përfshijnë paqartësi të shumta, audituesi arrin në përfundimin se, pavarësisht faktit që ai ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit në lidhje me secilën nga pasiguritë individuale, nuk është e mundur që ai të formojë një opinion mbi pasqyrat financiare për shkak të ndërveprimit të mundshëm të pasigurive dhe efekteve kumulative të mundshme të tyre në pasqyrat financiare.

Audituesi duhet të shprehë një opinion kundër kur ai, pasi ka siguruar evidencën e nevojshme të auditimit, arrin në përfundimin se anomali të në pasqyrat financiare, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura/pervasive.

Karakteristikat dhe dallimet e lëshimit të një Opinioni Kundër ose Refuzimit të Dhënies së Opinioni përcaktohen në dallimet kryesore mes këtyre dy llojeve të modifikimeve të

opinionit qëndrojnë në këto pika kryesore: SNA 750 'Modifikimet e opinionit në raportin e audituesit të pavarur'.

1. Natyrën e anomalive materiale të evidentuara gjatë procesit të auditimit;
2. Përshkrimin e përgjegjësisë së audituesit
3. Paragrafin e dhënies së opinionit

Pranueshmërinë e komenteve të partnerit tuaj:

ISA 700 shprehet se opinionin mund të firmoset vetëm në momentin që është marrë letra e përfaqësimit me shkrim e firmosur nga klienti.

Nëse audituesi nuk ka marrë letrën e përfaqësimit, logjikisht nuk ka evidencë të mjaftueshme për të firmosur raportin derisa të merret letra e përfaqësimit me shkrim. Për më tepër, arsyeja pse duhet që të merret ky përfaqësim i shkruar është që të mbahet parasysh cdo ngjarje e mëvonshme që mund të ndodhi para mbylljes së pasqyrave dhe firmosjes së opinionit.

Pra nuk është e pranueshme dhe është në kundërshti me ISA 700 që të firmoset dhe të vendoset data e raportit përpara se të merret përfaqësimi i shkruar.

- 20.** Listoni 5 tregues që janë të rëndësishëm në gjykimin e audituesit nëse një kontroll i entitetit ose disa kontrole bashkë, janë të rëndësishme për auditimin.

Cilat janë konsideratat shtesë që duhet të ketë parasysh audituesi në lidhje me efektin e mjedisit të kontrollit të një entiteti të vogël në vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale.

5 pikë

Përgjigje:

Faktorët që lidhen me gjykimin e audituesit nëse një kontroll, individualisht ose në kombinim me të tjerët, është i rëndësishëm për auditimin, mund të përfshijnë çështje të tilla si:

- Materialiteti.
- Rëndësia e rrezikut të lidhur.
- Madhësia e njësisë.
- Natyra e biznesit të njësisë ekonomike, duke përfshirë organizimin e saj dhe karakteristikat e pronësisë.
- Diversiteti dhe kompleksiteti i operacioneve të njësisë.
- Kërkesat ligjore dhe rregullative të aplikueshme.
- Rrethanat dhe komponenti i zbatueshëm i kontrollit të brendshëm.
- Natyra dhe kompleksiteti i sistemeve që janë pjesë e kontrollit të brendshëm të entitetit, duke përfshirë përdorimin e organizatave të shërbimit.
- Nëse dhe si, një kontroll specifik, individualisht ose në kombinim me të tjerët, parandalon ose zbulon dhe korrigjon gabime materiale.

(Vetëm 5 nga faktorët më sipër duhen listuar për të marrë 2.5 pikë.)

Mjedisi i kontrollit brenda entiteteteve të vogla ka gjasa të ndryshojë nga entitetet më të mëdha. Për shembull, ata që janë të ngarkuar për qeverisje në entitete të vogla nuk mund të mos përfshijnë një anëtar të pavarur ose të jashtëm dhe roli i qeverisjes mund ndërmerret drejtpërdrejt nga pronari-menaxheri, kur nuk ka pronarë të tjerë. Natyra e mjedisit të kontrollit mund të ndikojë gjithashtu në rëndësinë e kontrolleve të tjera, ose në mungesën e tyre. Për shembull, përfshirja aktive e një pronari-menaxheri mund të zbusë disa nga rreziqet që rrjedhin nga mungesa e nëndarjes së detyrave në një njësi të vogël; megjithatë mund të rrisë rreziqet e tjera, përshembull, rreziku i anashkalimit të kontrolleve.

Përveç kësaj, të dhënat e auditimit për elementet e mjedisit të kontrollit në entitetet më të vogla mund të mos jenë të dokumentuara, në veçanti kur komunikimi midis drejtimit dhe personelit tjetër mund të jetë ende informal dhe efektiv. Për shembull, entitetet e vogla mund të mos kenë një kod të sjelljes të shkruar, por, në vend të kësaj, të zhvillojnë një kulturë që thekson rëndësinë e integritetit dhe të etikës së sjelljes përmes komunikimit me gojë dhe me shembullin që jep drejtimi.

Rrjedhimisht, qëndrimet, ndërgjegjësimi dhe veprimet e drejtimit ose të pronar-menaxherit janë të një rëndësie të veçantë për kuptimin e audituesit të mjedisit të kontrollit të entitetit të vogël.

- 21.** Në përfundim të çdo auditimi të kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, një auditues duhet të marrë nga Drejtimi Letrën e Përfaqësimit. Cilat përfaqësime që lidhen me mashtrimin dhe rrezikun e mashtrimit duhet të jenë patjetër në një letër përfaqësimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

4 pikë

Përgjigje:

Audituesi duhet të marrë Letrën e Përfaqësimit të firmosur nga Drejtimi dhe nëse është e nevojshme duhet të marrë përfaqësime edhe nga personat e ngarkuar me qeverisjen. Kjo leter përfaqësimi duhet të përmbajë:

1 – konfirmim nga Drejtimi se ata janë përgjegjës për hartimin, vënien në zbatim dhe mirëmbajtjen e një sistemi të kontrollit të brendshëm që parandalon dhe identifikon mashtrimet;

2 – konfirmim që Drejtimi ka deklaruar të audituesi vlerësimin e tij lidhur me rrezikun e pasaktësive në pasqyra financiare si pasojë e mashtrimeve;

3 – konfirmim që Drejtimi ka deklaruar të audituesi të gjitha rastet e njohura, ose të dyshuara të mashtrimit që përfshijnë:

- i) Drejtimin
- ii) Punonjës që kanë role të rëndësishme në kontrollet e brendshme
- iii) Persona të tjerë, në rastet kur mashtrimi mund të ketë efekt material mbi pasqyrat financiare

4 - konfirmim që Drejtimi ka deklaruar të audituesi të gjitha deklaratat / pretendimet e njohura, ose të dyshuara të mundësive të mashtrimit që mund të ndikojë pasqyrat

financiare e qe jane komunikuar nga punonjes ose ish-punonjes te shoqerise, analiste, rregullatore ose te tjere.

22. S&P Shpk është një Shoqëri auditimi, e cila ka pësuar rënie të të ardhurave në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të fundit.

Shoqëria kërkon që të rrisë të ardhurat si dhe numrin e klientëve dhe për këtë, ka zhvilluar një strategji të re reklamimi ku garanton që auditimet e saj do të minimizojnë ndërprerjen e aktivitetit të Shoqërive, duke mos zgjatur më shumë se dy javë. Gjithashtu, S&P Shpk i ka ofruar të gjithë klientëve të rinj të auditimit një shërbim falas lidhur me përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin e pare te angazhimit, pasi mendohet se koha e shpenzuar për auditimin do të zvogëlohet nëse Shoqëria ka përgatitur këto pasqyra.

Shoqëria kërkon të zvogëlojë shpenzimet e auditimit dhe për këtë arsye ka vendosur të mos përditësojë letrat e angazhimit të klientëve ekzistues, mbi supozimin se këto të fundit nuk pritet të ndryshojnë shumë nga viti në vit.

Një nga klientët ekzistues të S&P Shpk ka propozuar që tarifa e auditimit të këtij viti duhet të bazohet në një përqindje të fitimit para tatimit të klientit. Partnerët kanë qëndrim pozitiv ndaj këtij propozimi pasi ata besojnë se tarifa e përgjithshme e auditimit do të rritet.

Së fundmi, S&P Shpk ka kontraktuar një klient të ri auditimi, C&B Shpk, i cili raporton më 31 dhjetor. C&B Shpk kërkon që auditimi i tyre të përfundojë deri në fund të muajit shkurt; moment i cili është shumë i ngarkuar për Shoqërinë S&P Shpk, dhe për këtë arsye do të angazhojë më shumë punonjes pa eksperiencë, pasi vetëm ata janë në dispozicion. Përveç kësaj, për të mos harxhuar kohë dhe kosto, S&P Shpk nuk ka kontaktuar me audituesit e mëparshëm të C&B Shpk.

Kërkohet:

Duke përdorur informacionin e mësipërm:

Identifikoni dhe shpjegoni katër nga rreziqet etike të cilat rrjedhin nga veprimet e shoqërisë.

5 pikë

Përgjigje:

1–S&P ka premtuar se auditimi nuk do të zgjasë më shumë se dy javë, duke mos shkaktuar ngadalësim të aktivitetit të shoqërive, por cdo auditim është i ndryshëm dhe kërkon një kohë të caktuar për tu finalizuar. Për më tepër, auditimet komplekse mund të mos mbyllen për dy jave, pasi ekipi i auditimit mund të mos mbledhë evidencë të mjaftueshme auditimi duke cënuar kështu saktësinë e opinionit të auditimit.

2–S&P u ka ofruar shoqërive shërbimin falas të përgatitjes së pasqyrave financiare që është një shërbim në konflikt interesi me auditimin e pasqyrave. Për më tepër, nëse ky shërbim ofrohet falas, në mënyrë që të gjenerojë fitimet e veta S&P do të jetë e prirur të minimizojë sa më shumë procedurat e auditimit duke rritur kështu përsëri rrezikun e auditimit dhe mundësinë e lëshimit të një opinion të pasaktë.

3–S&P nuk po përditëson letrat e angazhimit me supozimin se ato nuk ndryshojnë shumë nga viti në vit. Kjo praktikë nuk është në përputhje me SNA 210 që kërkon që edhe

në rastet kur letrat e angazhimit nuk ndryshohen, ato duhet gjithsesi të rishikohen për të parë nëse mbeten të përshtatshme me rrethanat në cdo vit.

4–Përcaktimi i tarifës së auditimit bazuar në një përqindje të fitimeve krijon konflikt të hapur interesi për shoqërinë audituese (dhe për më tepër është gati e pamundur të meren masa mbrojtëse për të mënjeluar këtë konflikt) pasi shoqëria audituese është drejtpërdrejt e motivuar ndaj deklaramit të pasqyrave financiare me fitim më të lartë nga ana e shoqërisë në mënyrë që të maksimizojë tarifat e saj.

5–S&P synon të përdorë punonjës paeksperiencë për klientin e ri për shkak të fluksit të punës në periudhën e shkurtit. Meqënëse ky është një auditim i ri, S&P ka shumë pak njohuri për biznesin si dhe të rreziqeve që ky auditim përmban. Përdorimi i punonjësve pa eksperiencë e ekspozon ndjeshëm shoqërinë audituese ndaj rrezikut të dhënies së opinionit jo të saktë, nga pamundësia e punonjësve për të përcaktuar drejt nëse puna e kryer dhe evidenca e mbledhur është e mjaftueshme për të mbështetur opinionin e auditimit.

6–Mos kontaktimi i audituesit paraardhës rrit mundësinë që shoqëria audituese të mos vihet në dijeni të rreziqeve, gabimeve, apo sjelljeve jo-etike të shoqërisë – që mund të kenë qënë dhe arsyeja e ndryshimit të audituesit. Komunikimi me audituesin paraardhës, në varësi të çështjeve që identifikohen, mund të shkaktojë edhe refuzim të angazhimit nga audituesi pasardhës.

Shënim : 5 raste të identifikuar mjaftojnë, secila vlerësohet me 1 pikë.

23. Ju keni qënë audituesi i shoqërisë ABC sh.p.k. për pasqyrat financiare të mbyllura me 31 dhjetor 2017. Komiteti i Auditimit të kësaj shoqërie ju ka kërkuar që të jeni prezent në mbledhjen e radhës së Komitetit të Auditimit për të raportuar mbi punën e kryer në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare.

Kërkohet:

Hartoni një raport të përmbledhur për Komitetin e Auditimit, ku të përmbledhen çështjet që duhet ti raportohen personave të ngarkuar me qeverisjen sipas kërkesave të SNA 260.

Supozime:

Pasqyrat financiare për vitin 2017 janë përgatitur në përputhje me SNK/SNRF.

Opinionin e auditimit është lëshuar me rezervë për zërin e inventarit meqënëse ju u emëruat si auditues të jashtëm pas datës 31 dhjetor 2017 dhe nuk mundet të mernit pjesë në inventarizimin fizik.

Të njëjtën çështje, audituesi e ka përfshirë edhe në Letrën e Rekomandimeve për Drejtimin.

5 pikë

Përgjigje:

Drejtuar: ABC sh.p.k

Nga: Shoqëria audituese X

Në vëmendje: Komitetit të Auditimit

Data : 15 prill 2018

- Objekti i auditimit : Objekti i auditimit tonë ishin pasqyrat financiare të shoqërisë ABC shpk për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 të përgatitura në përputhje me SNK/SNRF.
- Auditimi ynë u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.
- Në përputhje me përgjegjësitë tonë sipas Letrës së Angazhimit me shoqërinë ABC shpk, ne kemi dorëzuar opinionin e auditimit dhe Letrën e Rekomandimeve për Drejtimin në datë 30 mars 2018.
- Opinioni ynë i auditimit mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë të përgatitura në përputhje me SNK/SNRF për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është lëshuar me rezervë për shkak të pamundësisë tonë për të marrë evidencë të mjaftueshme në lidhje me gjendjen e inventarit të shoqërisë më 31.12.2017 duke qënë se ne u emëruam si auditues të jashtëm të shoqërisë ABC shpk pas datës 31.12.2017. Në këto kushte dhe në pamundësi për tu siguruar për sasinë e inventarit nëpërmjet metodave të tjera alternative në nuk mund të japim siguri të arsyeshme se inventari është paraqitur saktë nga shoqëria në pasqyrën e pozicionit financiar më 31.12.2017.
- Në Letrën e Rekomandimeve për Drejtimin ne kemi përfshirë çështjen e emërimit të audituesit përpara datës së mbylljes së pasqyrave financiare. Në këtë mënyrë, duke konsideruar materialitetin e gjendjes së inventarit të shoqërisë, shoqëria audituese mund të jetëprezente në numerimin fizik të inventarit dhe marrjen e evidencës së nevojshme për gjendjen e inventarit duke mundësuar kështu shprehjen e një opinioni pa rezervë për pasqyrat financiare. Zakonisht, është e vështirë marrja e evidencës së mjaftueshme për gjendjen e inventarit me mënyra alternative përveç procedurës së numërimit fizik. Drejtimi është shprehur në përgjigjet e Letrës së Rekomandimeve se do ta marrë parasysh këtë rekomandim për auditimin e vitit që mbyllet me 31 dhjetor 2018.
- Ne kemi vlerësuar pavarësinë e shoqërisë audituese dhe të ekipit të punës së angazhuar me auditimin e ABC shpk dhe nuk kemi identifikuar çështje që mund të çënojnë pavarësinë e audituesit ose kërkesat e etikës.
- Gjatë auditimit në patëm bashkëpunimin e Drejtimit dhe stafit përgjegjës për dhënien e informacionit financiar dhe jo-financiar në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare.
- Gjatë auditimit tonë në nuk identifikua çështje të rëndësishme që lidhen me mashtrimin ose mos-përputhjen e shoqërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Gjatë auditimit tonë ne nuk identifikua çështje të tjera që duhet tju komunikohen ju përveç atyre të cituara më lart.

- 24.** Përshkruani 5 procedura thelbësore auditimi, nëpërmjet të cilave merret evidencë auditimi. Ilustroni secilën prej tyre, në situatën praktike të auditimit të një shoqërie tregtare që merret me shitje me pakicë në tregun vendas dhe mallin e importon.

5 pikë

Përgjigje:

1. Inspektimi–inspektimi kupton ekzaminimin e dokumentacionit dhe të të dhënave, si të brendshme ashtu edhe të jashtme, në formë elektronike ose të shkruara, ose vrojtim fizik i aktiveve.

Shembull: Vrojtimi fizik i aktiveve të shoqërisë, ose i inventareve.

2. Procedurat analitike–janë vlerësime/analiza të informacionit financiar nëpërmjet vrojtimit të marrëdhënieve midis gjendjeve/klasave të transaksioneve, ose nëpërmjet korelacionit midis të dhënave financiare me ato jo-financiare. Gjithashtu në procedurat analitike përfshihen edhe ekzaminimi i shmangieve të rezultateve aktuale nga ato të pritura/të parashikuara.

Shembull: Krahasimi i gjendjeve në vitin aktual me ato të vitit të kaluar, për të kuptuar ndryshimet thelbësore dhe për ti diskutuar ato me manaxhimin.

3. Rillogaritja-rillogaritja mund të jetë manual ose elektronike dhe nënkupton verifikimin e saktësisë matematikore të dokumentacionit, ose të të dhënave.

Shembull: Rillogaritja e amortizimit të vitit bazuar në rregjistrin e aktiveve për të krahasuar vlerën e rillogaritur me atë të deklaruar nga shoqëria.

4. Konfirmimet nga palët e treta– është një formë evidencë që audituesi e merr direkt nga palët e treta (në përgjigje të një kërkesë për konfirmim të nisur nga audituesi dhe të aprovuar nga shoqëria). Mund të jetë në formë elektronike ose të shkruar në varësi të kërkesës së dërguar.

Shembull: Marrja e konfirmimit bankar nga secila banke me të cilën shoqëria ka zhvilluar transaksione gjatë vitit.

5. Pyetësorët– janë një mjet për mbledhjen e informacionit si financiar ashtu edhe jo-financiar nga persona me njohuri për shoqërinë si brenda edhe jashtë saj. Pyetësorët mund të përdoren për të mbledhur evidencë auditimi si gjatë fazës së planifikimit ashtu edhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurave të auditimit.

Shembull: Pyetësor me drejtuesin e departamentit të blerjeve për të marrë informacion mbi diferencat e identifikuar gjatë verifikimit të faturave të importit.

6. Ribërja e një veprimi / një kontrolli – nënkupton përsëritjen ose ribërjen nga audituesi të një veprimi / kontrolli të bërë më përpara nga shoqëria.

Shembull: Ribërja e kontrollit mujor të rakordimit bankar.

Shënim: 5 procedura mjaftojnë / secila vlerësohet me 1 pikë

25. Cilat janë përgjegjësitë për raportim të audituesit në rastin e angazhimeve fillestare sipas SNA 510 lidhur me anagzhimet fillestare të auditimit – tepricat e çeljes? Përkrahja udhëzimet kryesore lidhur me përgjegjësitë e audituesit për tepricat e çeljeskur pasqyrat auditohen për herë të parë, ose kur pasqyrat financiare të vitit të shkuar janë audituar nga një auditues tjetër.

4 pikë

Përgjigje:

Përgjegjësitë për raportim në rastin e angazhimeve fillestare

Tepricat e çeljes

1. Nëse audituesi nuk ka qënë në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me tepricat e çeljes, sipas rrethanave, ai duhet të shprehë një opinion me rezervë ose të heqë dorë nga dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, në përputhje me SNA705.

SNA 705 vendos kërkesa dhe jep udhëzime mbi rrethanat të cilat mund të cojnë në një opinion të modifikuar në raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare, për llojin e opinionit të përshtatshëm sipas rrethanave, dhe për përmbajtjen e raportit të auditimit kur opinionit i audituesit është i modifikuar. Pamundësia e audituesit për të marrë evidence auditimi të nevojshme lidhur me tepricat e çeljes mund të rezultojë në një nga modifikimet e mëposhtme të opinionit në raportin e audituesit:

(a) Një opinion me rezervë ose një refuzim për të dhënë opinion, të përshtatshëm në varësi të rrethanave; ose

(b) Përvetse kur ndalohej nga ligji apo nga ndonjë rregullore tjetër, një opinion i cili është me rezervë ose një refuzim për të dhënë opinion, sipas rastit, lidhur me rezultatet e operacioneve, dhe flukset e parasë, kur konsiderohet e përshtatshme, dhe një opinion i pa modifikuar lidhur me pozicionin financiar.

2. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se tepricat e çeljes përmbajnë anomali të cilat prekin në mënyrë materiale pasqyrat financiare të periudhës aktuale dhe efekti i anomalive nuk është paraqitur ose shpjeguar siç duhet, audituesi, në varësi të rrethanave, do të shprehë një opinion me rezervë ose të heqë dorë nga dhënia e opinionit në përputhje me SNA 705.

Përshtatshmëria e Politikave Kontabël

3. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se:

(a) politikat kontabël të periudhës aktuale në lidhje me tepricat e çeljes nuk janë zbatuar siç duhet në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; ose

(b) një ndryshim në politikat kontabël nuk është kontabilizuar ose paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të mjaftueshme ose për të nuk janë dhënë informacionet shpjeguese në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar,

audituesi, në varësi të rrethanave, duhet të shprehë një opinion me rezervë ose një opinion kundër në përputhje me SNA 705.

Modifikimi i opinionit në Raportin e Audituesit Paraardhës

4. Nëse opinionit i audituesit paraardhës lidhur me pasqyrat financiare të periudhës paraardhëse, ka përfshirë një modifikim në opinion, i cili vijon të mbetet i përshtatshëm dhe material edhe për pasqyrat financiare të periudhës aktuale, audituesi duhet të modifikojë opinionin për pasqyrat financiare të periudhës aktuale në pajtim me SNA 705 dhe SNA 710

Në disa situata, një opinion i modifikuar në raportin e audituesit paraardhës mund të mos jetë i përshtatshëm dhe material për opinionin mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Ky mund të jetë rasti kur, për shembull, ka patur kufizim të objektit në periudhën paraardhëse, por çështja që ka çuar në kufizimin e objektit në periudhën aktuale është zgjidhur.

26. Ju jeni përgjegjës për auditimin e Shoqërisë B, dhe po planifikoni auditimin përfundimtar të pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018. Shoqëria B ka blerë tokë në zonën tregtare dhe industriale të qytetit dhe vlera e tokës është materiale. Toka momentalisht është dhënë me qira dhe klasifikohet si pronë/aktivi investuar në pasqyrat financiare. Ju keni vendosur të përdorni një ekspert gjatë auditimit tuaj, për të marrë evidencë nga ky ekspert në lidhje me vlerën e drejtë të tokës.

Shpjegoni çështjet që duhet të merren parasysh nga audituesi për të vlerësuar se sa e besueshme është puna e ekspertit lidhur me vlerën e tokës.

4 pike

Përgjigje:

Për të vlerësuar sa e besueshme është puna e ekspertit, audituesit duhet të marrin parasysh: Pavarësinë, Kompetencën Profesionale (ose Ekspertizën), Qëllimin e Punës dhe Përfundimet e arritura.

Pavarësia:

Audituesi duhet të vlerësojë nëse eksperti është i pavarur nga klienti, dhe kështu duhet të hetojë nëse ata kanë ndonjë interes ose marrëdhënie që mund të kërcënojnë pavarësinë e tij. Për shembull, eksperti nuk duhet të jetë një palë e lidhur e kujtdo që ka ndikim mbi pasqyrat financiare. Puna është më pak e besueshme nëse ekspertët nuk janë të pavarur.

Ekspertiza:

Aftësia e ekspertit duhet të vlerësohet, p.sh. duke parë nëse është i licensuar apo anëtar i organizatave përkatëse profesionale. Duhet të merret parasysh edhe përvoja relevante e ekspertit. Një ekspert me përvojë të gjerë në vlerësimin e pronave si toka dhe investime në prone do të jetë më i besueshëm se sa dikush i sapo kualifikuar me përvojë relativisht të pakët. Në këtë rast, një vlerësues ekspert mund të jetë një vlerësues i licensuar me eksperiencë, i cili do t'i jepte besimin audituesit në besueshmërinë e punës së tij.

Qëllimi i punës

Audituesi duhet të dakordojë me ekspertin qëllimin e punës, të përfshijë objektivat e tij dhe si do të përdoret puna e ekspertit në lidhje me auditimin, metodologjinë dhe çdo supozim kyç që do të përdoret. Këto supozime duhet të përputhen me kuptimin e audituesit për entitetin dhe mjedisin e tij. Qëllimi duhet të përcaktohet që në fillim të angazhimit. Nëse eksperti devijon nga ky qëllim, atëherë puna e tij do të jetë më pak e dobishme për audituesin.

Përfundimi (Konkluzioni)

Audituesi konsideron burimin e të dhënave dhe të dhënat e përdorura nga eksperti duke u përqendruar në sa të besueshme dhe në përputhje me kuptimin e audituesit janë ato. Audituesi pastaj vlerëson konkluzionet e nxjerra nga eksperti dhe nëse ato janë të mbështetura nga evidenca e marrë. Çdo mospërputhje duhet të hetohet.

27. Ju jeni menaxheri përgjegjës për auditimin e Shoqërisë A. Ju jeni duke shqyrtuar dokumentet e punës lidhur me vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2017. Shoqëria A është një prodhues i barnave.

Ekipi i auditimit ju ka informuar për disa çështje të rëndësishme:

- a - Si pjesë e shqyrtimit tuaj për ngjarjet pas periudhës raportuese, ju merrni pasqyrat financiare për janar dhe shkurt 2018 dhe krahasoni rezultatet me vitin e kaluar. Shpenzimet e amortizimit për muajin shkurt të këtij viti janë 1 milione lekë më pak se një vit më parë. Në hetimin e mëtejshëm, ju zbuloni se një nga fabrikat prodhuese është djegur në janar 2018. Nuk ka pasur dëme në njerëz, por fabrika ishte e vetmja që prodhonte disa lloje produktesh me rëndësi për biznesin që jepnin një avantazh të madh konkurrues në industri. Do të duhen kohë dhe investime të mëdha për ta zëvendësuar atë fabrikë.
- b - Gjatë vitit 2017, një prej drejtuesve të shoqërisë, bleu një makinë nga kompania, e cila kishte vlerë tregu prej 1 milione lekë dhe vlerë kontabël prej 800 mijë lekë. Makina u shit për vlerën prej 800 mijë lekë dhe është ende e papaguar.

Komentoni dy çështjet që duhet të konsiderohen dhe pershkruani evidencën e auditimit që duhet të gjeni në dosje gjatë shqyrtimit tuaj të dokumenteve të punës të auditimit në lidhje me secilën nga çështjet e pershkuara më lart.

5 pike

Përgjigje:

a- Kjo ngjarje dhe efekti i saj financiar i vlerësuar duhet të pershkruhen në shënimet sqaruese të pasqyrave financiare, sepse kjo ngjarje përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm në aktivitet, për shkak të rëndësisë dhe vecantisë së produkteve të prodhuara në fabrikën e djegur. Pasqyrat financiare nuk do të rregulloheshin (axhustoheshin) sepse djegia nuk ishte një situatë që ekzistonte në fund të vitit, por ka ndodhur më pas.

Evidenca përfshin:

-Kopje të dokumenteve që tregojnë për rënien e zjarrit dhe djegien e fabrikës, si edhe efektet financiare dhe vlerën kontabel të fabrikës sipas regjistrit të aktiveve afatgjata dhe librave kontabël.

-Rishikim të parashikimeve financiare dhe llogarive të menaxhimit për të kuptuar shumën e të ardhurave të gjeneruara nga fabrika e djegur dhe nga fabrikat e mbetura për të kuptuar rëndësinë e të ardhurave të munguara të fabrikës në të ardhmen dhe në aktivitetin vijues të shoqërisë. Këto parashikime duhet të përfshijnë një vlerësim të vlefshmërisë së çdo supozimi të përdorur nga menaxhimi dhe konfirmimin nëse ato janë në përputhje me kuptimin e audituesit për biznesin.

-Evidencë të diskutimeve me menaxhimin lidhur me përdorimin e ardhshëm të fabrikave, ndonjë investim në fabrika të reja dhe nëse priten produkte potenciale të reja që mund të prodhohen prej tyre.

-Plane të investimeve në ndonjë fabrikë të re dhe efektin e këtyre investimeve në aktivitet.

Nëse ngjarja ka efekte shumë të rëndësishme në aktivitetin e ardhshëm, ajo mund të krijojë pikëpyetje nëse biznesi është në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijimësisë. Në përputhje me SNK 1, në këtë rast menaxhimi duhet të vlerësojë nëse është në gjendje të vazhdojë në vijimësi. Nëse një ngjarje ndodh përpara se pasqyrat financiare të jenë autorizuar për lëshim, dhe kuptohet se Shoqëria nuk mund të vazhdojë veprimtarinë e saj, atëherë pasqyrat financiare nuk duhet të përgatiten mbi bazën e parimit të vijimësisë.

b- Në përputhje me SNK 24 ky është një transaksion me palë të lidhura, sepse është kryer me një drejtues të shoqërisë. SNA 550 Palët e lidhura kërkon nga audituesi që të vlerësojë nëse këto transaksione janë kontabilizuar dhe treguar në shënimet sqaruese të pasqyrave në mënyrë korrekte. Ky është një transaksion i rëndësishëm me një drejtues dhe jo pjesë e aktivitetit të zakonshëm të biznesit, kështu që audituesi duhet të inspektojë kontratat bazë për të vlerësuar nëse:

- Ka pasur raportime financiare mashtruese ose keqpërdorim të aktiveve; dhe

- Kushtet e transaksionit janë në përputhje me shpjegimet e menaxhimit.

Duhet të sigurohet evidence lidhur me autorizimin dhe miratimin e duhur të transaksioneve.

Duhet krahasuar shuma me materialitetin por edhe nëse shuma është jomateriale, ky është një transaksion me personelin kryesor drejtues - një Drejtor - ky është material për nga natyra dhe prandaj duhet të sqarohet në shënimet e pasqyrave. Nëse sqarimi nuk është bërë, ose nuk është adekuat, atëherë kjo mund të rezultojë në një opinion të kualifikuar.

SNK 24 kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese për natyrën e marrëdhënies dhe detajet e transaksionit, përfshirë shumën, kushtet, dhe nëse shuma e arketueshme aktualisht është e papaguar.

Nëse shuma është ende e papaguar dhe mund të mos jetë e rikuperueshme, menaxhimi duhet të inkurajohet të bëjë rregullime të kërkuara edhe kur ato nuk janë materiale.

Evidenca përfshin:

-Rishikime shënimeve të pasqyrave financiare, për të konfirmuar se është bërë sqarimi i mjaftueshëm i kërkuar nga SNK 24.

- Kopja e faturave dhe barazimi i tyre me librin e llogarive të arkëtueshme për të konfirmuar shumën e papaguar.
- Kopjen e çdo kontratë ose dokumenti tjetër që ka të bëjë me shitjen e veturës dhe një rishikim të kushteve dhe afateve të tij, p.sh.percaktimin e kohës kur shuma është e detyrueshme për pagesë.
- Ekstrakti bankar dhe librii arkës për të konfirmuar nëse shuma është pranuar pas periudhës raportuese.
- Dokumentimi se vlera kontabël e veturës është hequr nga regjistri i aktiveve afatgjata dhe libri i përgjithshëm kontabel. Dokumentim për cdo efekt të mundshëm të njohur në fitim ose humbje.
- Shqyrtimi i shënimeve nga mbledhjet e bordit, apo ndonjë dokument tjetër aprovues, për të konfirmuar se transaksioni ishte autorizuar në mënyrë të përshtatshme.
- Letra e përfaqësimit me shkrim nga drejtuesit me deklarimin se ka informuar audituesin për identitetin e palëve të lidhura, dhe për të gjitha marrëdhëniet dhe transaksionet me palë të lidhura për të cilat ata janë në dijeni, dhe se drejtimi ka kontabilizuar dhe sqaruar në pasqyra në mënyrë të përshtatshme marrëdhëniet dhe transaksionet e tilla në përputhje me SNK 24.

28. Shoqëria A shet mobilje nga 15 pika shitje. Shitjet bëhen me para ose me karta krediti e debiti. Të gjitha mobiljet dorëzohen tek klientet duke përdorur makinat e transportit të shoqërisë. Drejtuesit tregojnë se Shoqëria A ka pasur një vit të vështirë, por megjithatë ka pasur rezultate të pranueshme. Rezultatet për dy vitet e fundit janë paraqitur më poshtë:

	2017	2016
Të ardhura nga shitja	750	650
Kosto e shitjeve	(350)	(440)
Marzhi bruto	400	210
Shpenzime operative		
Administrative	(120)	(130)
Shpenzime të shitjes	(90)	(80)
Interesa të paguar	(10)	(10)
Interesa të fituar	15	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	195	(10)
<i>Informacion nga bilanci:</i>		
Arka dhe banka	25	(95)

Kërkohet:

- a) Cfarë kuptohet me termin 'procedura analitike'?
- b) Cilat janë disa nga llojet e ndryshme të procedurave analitike në dispozicion të auditorit në përgjithësi dhe në këtë rast;
- c) Në cilat situata, mund të përdoren procedurat analitike në auditim.
- d) Shpjegoni procedurat e nevojshme për të marrë një letër konfirmimi nga banka me të cilën operon Shoqëria A.

5 pike

Përgjigje:

a- Sipas SNA 520 Procedurat analitike, procedurat analitike janë vlerësimi i informacionit financiar përmes analizës së marrëdhënieve të besueshme midis të dhënave si financiare dhe jofinanciare. Procedurat analitike mund të përfshijnë krahasime të të dhënave financiare duke përfshirë analizën e tendencave dhe llogaritjen dhe krahasimin e raporteve.

b- Procedurat analitike përfshijnë krahasimin e informacionit financiar të Shoqërisë me, për shembull:

- Informacionin krahasues për periudhat e mëparshme;
- Rezultatet e parashikuara nga drejtuesit, siç janë buxhetet apo parashikimet;
- Pritshmëritë e audituesit; ose
- Informacion krahasues për konkurrentët.

Në rastin konkret mund të krahasohen të ardhurat dhe shpenzimet e vitit aktual me vitin paraprak, duke diskutuar variancat e rëndësishme me një punonjës të përshtatshëm dhe të kryhen edhe procedurat e detajuara nëse është e nevojshme. Kjo vecanerisht për kostot e shitjeve dhe marzhin bruto që ka ndryshuar shumë nga një vit në tjetrin.

Krahasohen shpenzimet aktuale me shpenzimet e buxhetuara dhe diskutohen me një punonjës dhe kryhen procedurat mëtejshme, nëse kërkohet.

Hetime të metejshme: Nëse gjykohet e nevojshme, kostot mund të vazhdojnë të testohen dhe hetohen duke parë dokumenta mbështetës si urdhra blerje e fatura dhe pastaj mund të krahasohen me buxhetet, duke i bërë pyetje menaxhimit në lidhje me ndonjë kosto që nuk është e buxhetuar.

Testimi i prerjes së periudhës: Mund të rishikohen edhe shumat pas datës raportuese për të siguruar se ato që lidhen me vitin financiar aktual janë përlllogaritur dhe regjistruar në vitin e duhur.

Kuptimi i biznesit: Diskutoni natyrën e shpenzimeve dhe të të ardhurave me një punonjës të përshtatshëm, në mënyrë që të krijohet një pritshmeri për shpenzimet dhe të ardhurat dhe të krijohen procedurat specifike të testimit.

c- Procedurat analitike kryhen në fazën e planifikimit, procedurat e detajuara dhe finalizimit të auditimit, pra në të gjitha fazat.

Procedurat e kryera në fazën e planifikimit e ndihmojnë audituesin të identifikojë dhe t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme rrezikut dhe ndihmojnë audituesin të kuptojë të kompaninë e audituar. SNA 315 Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të gabimeve materiale përmes kuptimit të entitetit dhe mjedisit të tij kërkon që audituesi të kryejë procedurat analitike si pjesë e procedurave të vlerësimit të rrezikut në fazën e planifikimit të auditimit për të siguruar një bazë për identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të gabimit material në pasqyrat financiare dhe në nivel llogarish dhe pohimesh. Është thelbësore që të kryhen procedurat analitike për të kuptuar fushat kryesore në pasqyrat financiare si dhe trendet dhe anomalitë kryesore (në informacionin financiar dhe midis informacionit financiar dhe jofinanciar). Kjo do të lejojë auditorin të vlerësojë fushat ku ka një rrezik më të madh të gabimeve materiale. Procedurat analitike janë pjesë e strategjisë dhe planit të auditimit.

Ato mund të ndihmojnë audituesin të identifikojë transaksione të pazakonta ose ngjarje të rëndësishme që ndodhin vetëm një herë. Shuma të cuditshme, raporte dhe tendenca që nuk priten mund të tregojnë se ka çështje me rrezik për gabime. Marrëdhënie të pazakonta ose të papritura të gjetura me këto procedurat, mund të ndihmojnë audituesin

të identifikojë risk të gabimeve materiale dhe mashtrimit. Procedurat perdoren si gjatë planifikimit, ashtu edhe gjatë testimeve në detaje dhe gjatë finalizimit të auditimit. Rezultatet e këtyre procedurave rikonsiderohen në fazën finale dhe nëse gjenden gabime pasqyrat financiare ato duhet të rregullohen. Në fazën finale këto procedura ndihmojnë për të arritur një konkluzion nëse pasqyrat financiare janë konsistente me kuptimin e audituesit për entitetin.

Që procedurat analitike të përdoren duhet të kemi mundësinë për të bërë lidhje dhe parashikime dhe të kemi informacion mjaftueshëm të detajuar, të besueshem, të krahasueshëm e relevant. Njohuria nga vitet e mëparshme mund të përdoret.

d- Për të marrë një letër konfirmimi nga banka, së pari duhet të kemi nga klienti listën e plotë të bankave me të cilat është operuar gjatë vitit, dhe kontaktet dhe adresat e secilës bankë për qëllime të marrjes së konfirmimit.

Në rastin konkret shohim balanca pozitive dhe negative dhe për këtë arsye duhet që modeli i letrës së konfirmimit të parashikojë kërkesën për konfirmim të të dyja llojeve të balancave, sidomos në vitin e parë të auditimit kur duhet të marrim konfirmim edhe për tepricat e celjes.

Audituesit duhet ta dërgojnë vetë dhe ta marrin direkt konfirmimin nga banka, dhe sigurisht të informojnë klientin për dërgimin e konfirmimeve dhe nëse ka diferenca midis konfirmimit nga banka dhe regjistrimeve kontabël dhe dokumenteve të rikoncimit të bankave, duhet të kërkojnë sqarime për diferencat. Nëse ka gabim duhet të rekomandohet rregullim i tyre. Nëse konfirmimet vonohen duhen dërguar kujtesa në bankë, dhe nëse konfirmimet nuk merren deri në përfundim të auditimit, duhen kryer procedura alternative psh duhen krahasuar tepricat sipas llogarive kontabël me ekstraktin e bankës.

Seksioni V

Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve për të Rishikuar (SNAR) & Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAR)

- 29.** Kur përdor punën e një eksperti profesionist të praktikës/auditues duhet të sigurojë evidencën e nevojshme, që tregon se puna e audituesit është e kënaqshme për qëllimet e angazhimit të dhënies së sigurisë. Cilat janë ato aspekte që duhet të vlerësojë profesionisti për të çmuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës të siguruar nga eksperti

4 pikë

Përgjigje:

Për të vlerësuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e evidencës të siguruar nga profesionisti i praktikës/audituesi vlerëson:

- (a) Kompetencën profesionale, përfshirë eksperiencën dhe objektivitetin e ekspertit;
- (b) Sa të arsyeshme janë supozimet, metodat dhe të dhënat bazë të përdorura nga eksperti; dhe
- (c) Sa të arsyeshme dhe domethënëse janë rezultatet e ekspertit në lidhje me rrethanat e angazhimit dhe konkluzionet e profesionistit të praktikës.

30. Per te realizuar një angazhim të dhënies së Sigurisë që Ndryshojnë nga Auditimet apo Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike, profesionisti i praktikës/audituesi duhet të planifikojë angazhimin në mënyrë të atillë që ai të kryhet me efektivitet. Tregoni çfarë përfshin procesi i planifikimit? Për çfarë ndihmon një planifikim i përshtatshëm?

Përmendni disa nga çështjet që trajtohen nga planifikimi i angazhimit.

5 pikë

Përgjigje:

Planifikimi përfshin zhvillimin e një strategjie të përgjithshme për objektin, rëndësinë, afatin, mënyrën e kryerjes së angazhimit, si dhe një plan angazhimi, i cili konsiston në një përshkrim të detajuar të natyrës, afatit të shtrirjes së procedurave të grumbullimit të evidencës, që duhen kryer, si edhe të shkaqeve për zgjedhjen e tyre.

Një planifikim i përshtatshëm ndihmon që t'i kushtohet vëmendja e duhur fushave më të rëndësishme të angazhimit, të identifikohen në kohë problemet e mundshme dhe të organizohet e drejtohet siç duhet angazhimi, me qëllim që ai të kryhet në mënyrë efektive dhe me efikasitet, profesionistin e praktikës që të ndajë në mënyrë të përshtatshme punën midis anëtarëve të grupit të angazhimit, si dhe lehtëson drejtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e punës së tyre.

Natyra dhe shtrirja aktivitetëve të planifikimit do të ndryshojë në avrësi të rrethanave të angazhimit, si për shembull, madhësia e kompleksiteti i entitetit dhe eksperiencia e mëparshme e profesionistit të praktikës me të. Shembuj të çështjeve kryesore që duhen përfshirë janë:

- Kushtet e angazhimit.
- Karakteristikat e çështjeve që trajtohen dhe kriteri i përcaktuar.
- Proçesi i angazhimit dhe burimet e mundshme të evidencës
- Njohja e profesionistit të praktikës me entitetin dhe mjedisin e tij, përfshirë rreziqet që informacioni mbi çështjet që trajtohen, mund të ketë anomali materiale.
- Identifikimi i përdoruesve të synuar dhe i nevojave të tyre, si dhe shqyrtimi i materialitetit dhe i elementëve përbërës të rrezikut të angazhimit për dhënien e sigurisë.
- Kërkesat për personel dhe ekspertizë, përfshirë këtu natyrën dhe shkallën e përfshirjes së ekspertit.

Planifikimi nuk është një fazë e shkëputur, përkundrazi ai është një proçes përsëritës e i vazhdueshëm. Si rezultat i ngjarjeve të paparashikuara, ndryshimit të kushteve, apo evidencë të siguruar nga rezultatet e procedurave të grumbullimit të evidencës, profesionisti i praktikës mund të ketë nevojë të rishikojë strategjinë e përgjithshme dhe planin e angazhimit, dhe për pasojë, bashkë me të, edhe natyrën, afatin e shtrirjen e planifikuar të procedurave të mëtejshme.

Klodian Mene

Kryetar

Komisioni i Provimeve të Aftësisë Profesionale